

VENDIM
Nr. 178, datë 28.3.2018

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 27, DATË 11.1.2012, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PROGRAMIN E NXITJES SË PUNËSIMIT TË GRAVE DHE
VAJZAVE NGA GRUPET E VEÇANTA”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 e 8, të ligjit nr. 7995, datë 20.9.1995, “Për nxitjen e punësimit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 27, datë 11.1.2012, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Kudo në vendim, emërtesat “Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë” dhe “Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes” zëvendësohen, përkatësisht, me fjalët “... ministria përgjegjëse për çështjet e punësimit dhe formimit profesional ...” dhe “... struktura përgjegjëse e ndihmës shtetërore ...”.

2. Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Për të përfituar nga ky program, punëdhënësi duhet të paraqesë pranë zyrës së punësimit ose të ngarkojë në mënyrë elektronike, dokumentet e mëposhtme:

a) Vetëdeklarimin dhe autorizimin për të lejuar nëpunësin përgjegjës të gjenerojë *online* dokumentacionin e nevojshëm;

b) Planin e biznesit të detajuar;

c) Dokumentacionin justifikues për rastet e detyrimeve ndaj organeve tatimore por që vërtetojnë se në momentin e aplikimit në këtë program:

i) kanë lidhur marrëveshjet përkatëse për shlyerjen e këtyre detyrimeve dhe janë të rregullt në shlyerjen e tyre;

ii) kanë shlyer detyrimet por kanë ende pa paguar gjokat;

iii) kanë shlyer detyrimet ose kanë vendosur garanci bankare për shumën e plotë të detyrimit, në përputhje me nenin 107, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe janë në proces të apelimit administrativ dhe në procese gjyqësore me organet tatimore.”.

3. Pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6. Zyra përkatëse e punësimit duhet të sigurojë për secilin punëdhënësi aplikues dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Ekstraktin historik të personit fizik apo juridik, që aplikon për programin, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit;

b) Vërtetimin për pagimin e detyrimeve tatimore;

c) Vërtetimin për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për tatimpaguesit, të specifikuar për tre muajt e fundit.

Zyra përkatëse e punësimit është përgjegjëse për plotësimin e dosjes së aplikimit.”.

4. Pika 21 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“21. Programi të fillojë të zbatohet gjatë vitit 2018 dhe kohëzgjatja e tij të jetë 5 (pesë) vjet.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama